

E nderuara Zëvendësguvernatore e Parë Gjoni,  
I nderuari Zëvendësguvernator Bajrami,  
I nderuari z. Noblet,  
I nderuari z. Chlad,  
Zonja dhe zotërinj të pranishëm

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë t'ju drejtohem me këtë fjalë rasti në këtë ceremoni të përmbylljes së Programit të Bashkëpunimit të Bankës Qendrore Evropiane dhe bankave qendrore kombëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bankën e Shqipërisë, dhe Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë. Ky program, i financuar nga Komisioni Evropian dhe i koordinuar nga Banka Qendrore Evropiane, u lancua një vit më parë me qëllimin që t'u ndihmojë të të tri bankave qendrore të regjionit tonë për inkuadrim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore. Sot, në përfundim të këtij programi them me bindje të plotë se ky program shënoi një hap të veçantë në rrugën tonë të integritit evropian. Prandaj, shprehim mirënjohjet më të larta si për Komisionin Evropian dhe Bankën Qendrore Evropiane, po ashtu edhe për bankat qendrore kombëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, të cilat dhanë kontributin e tyre me ekspertët e fushave të veçanta të bankingut qendror.

Përfundimi i këtij programi përkon me fundin e periudhës gjashtëmujore të programit gjatë së cilës u krye analiza e nevojave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Së këndejmi, në vijim do ta paraqes një përmbledhje të aktivitetit të zhvilluar të programit në lidhje me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Gjatë gjashtë muajve të fundit u analizuan nevojat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për zhvillime ligjore, organizative dhe të

resurseve të shtatë fushave të veprimtarisë së saj: 1) Stabiliteti Financiar, 2) Mbikëqyrja Bankare, 3) Sistemet e Pagesave, 4) Integrimi Evropian, 5) Teknologjia e Informacionit, 6) Administrata, dhe 7) Auditimi i Brendshëm. Gjatë analizës së nevojave, ka pasur një bashkëpunim të frytshëm ndërmjet personelit të angazhuar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe ekspertëve të përfshirë të Bankës Qendrore Evropiane dhe bankave qendrore kombëtare. Në kuadër të programit, janë bërë vlerësime të thella si në fushat tradicionale të politikave të bankës qendrore, po ashtu edhe në fushat mbështetëse dhe teknike, të cilat kanë sjellë identifikimin e zbrazëtirave dhe të aspekteve për t'u përmirësuar bashkë me përpilimin e veprimeve të rekomanduara. Veprimet e rekomanduara, të mbështetura në standarde evropiane dhe në ato ndërkombëtare, si dhe në praktikat më të mira, janë formuluar duke pasur parasysh rrethanat specifike të Kosovës si në pikëpamje të përmbytjes, po ashtu edhe në pikëpamje të afateve të zbatimit.

Në fushën e Stabilitetit Financiar, duke pasur parasysh rolin kyç të BQK-së në mbikëqyrjen e sistemit financiar, veprimet e rekomanduara kanë të bëjnë me konsolidimin e mëtejme të detyrave të lidhura me stabilitetin financiar nën mandatin e saj makro-prudencial. Në fushën e Mbikëqyrjes Bankare, rekomandohet në rend të parë, avancimi drejt Basel-it 3, me miratimin e kornizës rregullatore bankare të BE-së, me theks të veçantë në qeverisje korporative, kapital dhe likuiditet të kërkuar, dhe proces të rishikimit mbikëqyrës. Sa i përket fushës së Sistemeve të Pagesave, janë potencuar zhvillime të operimit të sistemeve në pajtim me praktikat më të mira evropiane dhe standardet ndërkombëtare të fushës, si dhe avancimi i rolit mbikëqyrës në pajtim me parimet e njohura në rrafshin ndërkombëtar dhe rregullativën e Bankës Qendrore Evropiane. Veprimet e rekomanduara në fushën e integritetit evropian kanë të bëjnë me riorganizimin e detyrave për ngritje të efikasitetit të kryerjes së përgjegjësive. Zhvillimi organizativ

rekomandohet edhe në fushën e teknologjisë së informacionit, me theks të veçantë në menaxhimin e rrezikut dhe në menaxhimin e projekteve. Më tej, në këtë fushë, si dhe në fushën e Administratës, janë dhënë rekomandime lidhur me adoptimin e standardeve të veçanta të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Në fushën e auditimit të brendshëm rekomandohet avancim i mëtejshëm drejt standardeve ndërkombëtare dhe udhëzuesit përkatës të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është e vendosur në zbatimin e suksesshëm të veprimeve të rekomanduara. Deri në muajin qershor të këtij viti, kemi paraparë përfshirjen e rekomandimeve në Planin Strategjik 2015-2019, duke përfshirë shtjellimin e plotë të zbatimit të tyre sa i përket afateve të sakta kohore, përgjegjësive individuale dhe grupore, dhe rezultateve konkrete të matshme.

Programi i bashkëpunimit me Bankën Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore kombëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, përpos rekomandimeve dhe njohurive teknike, i ka ofruar Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës edhe kalitjen e lidhjeve më të forta me bankat qendrore të vendeve të Bashkimit Evropian dhe avancimin e bashkëpunimit të përgjithshëm.

Duke e shfrytëzuar rastin e këtij adresimi para një audience të nderuar dhe meqë ndërlidhet me tematikën e Programit të bashkëpunimit me Bankën Qendrore Evropiane, do t'i them disa fjalë edhe për zhvillimet e fundit të sistemit financiar të vendit.

Sektori bankar i Kosovës ka vazhduar të shërbejë si shtyllë e rëndësishme për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe për promovimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Përveç që ka arritur t'i përballojë me shumë sukses zhvillimet e pafavorshme në ekonominë globale në vitet e fundit, sektori ynë bankar ka filluar të përshpejtojë

ritmin e rritjes së aktivitetit dhe, në të njëjtën kohë, t'i lehtësojë kushtet e kreditimit, gjë që tregon për rritje të mëtutjeshme të rolit të këtij sektori në përkrahje të ekonomisë së vendit.

Në përgjithësi, kreditë e lëshuara nga sektori bankar, në fund të vitit 2014, arritën vlerën prej 1.88 miliard eurosh, duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 4.2%, e cila është norma më e lartë e rritjes që është shënuar në dy vitet e fundit. Ky përshpejtim i rritjes së kreditimit reflekton lehtësimin e standardeve dhe të kushteve të kreditimit nga ana e bankave, gjë që flet për rritje të gatishmërisë së bankave për ta kredituar ekonominë, dhe poashtu reflekton rritjen e kërkesës për kredi si nga ekonomitë familjare, ashtu edhe nga ndërmarrjet.

Kontribut të rëndësishëm për zgjerimin e aktivitetit kredidhënës të bankave ka dhënë edhe qëndrueshmëria e burimeve të financimit të bankave, me ç'rast vendin kryesor e zënë depozitat e mbledhura brenda vendit. Në fund të vitit 2014, vlera e depozitave arriti në 2.54 miliard euro, që është për 3.6% vlerë më e lartë sesa në vitin paraprak.

Aktiviteti ndërmjetësues financiar u karakterizua me zvogëlim të normës mesatare të interesit si në depozita, ashtu edhe në kredi. Norma mesatare e interesit në depozita në fund të vitit 2014 ishte 1.1%, krahasuar me mesataren prej 2.4% në dhjetor 2013. Kjo rënie e normës së interesit në depozita, së bashku me zvogëlimin e kategorive tjera të shpenzimeve të bankave komerciale, kontribuuan në zvogëlimin e normës së interesit në kredi, me ç'rast për herë të parë, që nga funksionimi i sistemit bankar të Kosovës, norma mesatare e interesit në kredi zbriti në vlerë njëshifrore. Në dhjetor 2014, norma mesatare e interesit në kredi ishte 9.2%, krahasuar me mesataren prej 11.1% në dhjetor 2013. Zvogëlimi i kostos së ndërmjetësimit financiar padyshim se paraqet përmirësim të

rëndësishëm të kushteve të financimit për sektorin privat dhe pritet të ndikojë në rritje të investimeve dhe përmirësim të produktivitetit të këtij sektori. Duke marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të efikasitetit të sektorit bankar dhe përmirësimin e ambientit të përgjithshëm afarist në vend, konsiderojmë se po krijohen kushtet të favorshme për zvogëlim të mëtutjeshëm të kostos së financimit për ekonominë e vendit.

Sektori bankar ka përmbyllur vitin 2014 me një profit neto prej 60.1 milion eurosh, që është dukshëm më i lartë sesa profiti i regjistruar në vitet e kaluara. Kjo rritje e profitit reflekton reduktimin e shpenzimeve të sektorit bankar, përderisa të hyrat shënuan një rënie të lehtë. Profitabiliteti i sektorit bankar paraqet një shtyllë të rëndësishme të stabilitetit të sektorit, andaj edhe rritja e profitit në vitin e fundit paraqet një zhvillim të favorshëm për qëndrueshmërinë e këtij sektori.

Në bazë të të gjithë indikatorëve të shëndetit financiar, qëndrueshmëria e sektorit bankar vazhdon të jetë e kënaqshme. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit në fund të vitit 2014 qëndroi në 17.8% (16.7% në dhjetor 2013), që tregon se kapitalizimi i sektorit bankar vazhdon të jetë i lartë dhe i qëndrueshëm.

Cilësia e kredive vazhdon të jetë e mirë dhe ka shënuar përmirësim krahasuar me vitin paraprak. Pjesëmarrja e kredive joperformuese në tërësinë e kredive në fund të vitit 2014 u zvogëlua në 8.3%, nga 8.7% sa ishte në janar 2014. Po ashtu, kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë të mbuluara mirë nga provizionet për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë.

Sektori bankar po ashtu vazhdoi të ketë pozicion të fortë të likuiditetit me një raport të likuiditetit prej 43.3%, që tejkalon kërkesat rregullatore, si dhe raport kredi / depozita prej 73.1%.

Performancë të mirë gjatë kësaj periudhe kanë treguar edhe sektorët e tjerë të sistemit financiar të Kosovës.

Për dallim nga vitet paraprake, kur kishim zvogëlim të kreditimit nga institucionet mikrofinanciare, në vitin 2014 ky sektor zgjeroi kreditimin me 2.9% dhe shënoi profit prej 1.3 milion euro, gjë që tregon për rritje të rolit të këtij sektori në ekonominë e vendit.

Rritje e aktivitetit u shënuar edhe te kompanitë e sigurimeve, te të cilat vlera e primeve të shkruara gjatë vitit 2014 arriti në 82.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.7 përqind.

Asetet e sektorit pensional në dhjetor 2014 arritën vlerën prej 1.09 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 19.1 përqind. Gjatë vitit 2014, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës shënoi rritje të vlerës së aksionit dhe realizoi kthim bruto nga investimet në vlerë prej 66.7 milionë euro.

Këto zhvillime të favorshme në sistemin financiar kanë vazhduar edhe gjatë muajve të parë të vitit 2015 dhe, bazuar në gjendjen aktuale të sistemit si dhe pritjet për zhvillimet e përgjithshme ekonomike në vend gjatë këtij viti, presim që sistemi financiar i vendit do të vazhdojë të zgjerojë aktivitetin dhe të ruajë nivelin e lartë të qëndrueshmërisë edhe gjatë vitit 2015.

Në fund, më lejoni të theksoj se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mbetet e orientuar drejt bashkëpunimit të mëtejshëm me Bankën Qendrore Evropiane, krahas dhënies së kontributit të shumanshëm në integrimin evropian të vendit. Ashtu siç e kemi të përcaktuar në Vizionin tonë, ne synojmë të jemi institucion meritor në arritjen e integritit evropian të Republikës së Kosovës, përderisa sigurojmë mandatin tonë kryesor të nxitjes dhe ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar.

Ju faleminderit shumë për vëmendjen tuaj.